

Informatat mbi Projektin

Emri i Projektit:	Punëtorët e rinjë për njerëz të rinjë
Vlera e projektit:	Shuma e përgjithëshme: € 14,977.96
Kohëzgjatja:	Fillimi: 01/09/2019 Përfundimi: 28/02/2020
Organizata implementuese:	Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime- SIT
Kontaktet e Organizatës: Adresa, e-maili, telefonat.	adresa: Rr. Fehmi Agani H1, Nr. 16, 10000 Prishtinë/ Kosovë e-mail: info@sit-ks.org web: www.sit-ks.org Tel: +383 (0) 38 223 457; +383 (0) 49 566 031
Grupet e synuara:	25 përfaqësues/e të OJQ-ve, KVRL-ve, punëtorët/et social/e, punonjës/e të rinisë do të jenë nga mosha 18-29 vjeçar me përfshirje gjinore të barabartë me burra dhe gra nga shtatë regjionet e Kosovës, duke u fokusuar sidomos në komunat më të vogla dhe zonat rurale. Gjithashtu, do të ketë edhe pjesëmarrës/e nga komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptas si dhe komunitetet serb apo boshnjak - që përfaqësojnë OJQ dhe janë punonjës/e të rinisë.
Partnerët:	Youth for Exchange and Understanding International (YEU International)
Territori i synuar/shtrirja gjeografike:	Kamenicë, Istog, Vushtrri, Deçan, Dragash, Viti, Klinë, Lipjan, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Obiliq.
Qëllimi i përgjithshëm:	Qëllimi i "Youth Workers for Young People" është të përmirësojë cilësinë e punës rinore dhe edukimit joformal përmes ngritjes së kapaciteteve të 25 punonjësve/eve të rinisë të OJQ-ve në Kosovë duke u fokusuar për të ndërtuar kapacitetet dhe kompetencat e tyre kryesore me fokus në zhvillimin e katër dimensioneve: qëndrimet, njohuritë, aftësitë dhe sjelljet.
Aktivitetet kryesore:	Faza zero / sesione para-trajnuese; EXPLORING YOUTH WORK - Trajnimi i parë tre (3) ditorë / residencial me 25 punonjës/e të rinisë + 2 trajnerë ndërkombëtarë + 3 staf ndihmës (3 ditë); EXPLORING TOOLS - Punonjësit/et e rinisë të përzgjedhur për projekt - eksplorimi i mjeteve pas kurseve të trajnimit; Young Youth Work Providers for Young People - trajnimi i dytë residencial (Ndarja e mjeteve mes vete dhe planifikimi i kuadrit të veprimit) 25 pjesëmarrës/e (punonjës/e të rinisë), 2 trajnerë ndërkombëtarë dhe 3 staf ndihmës).
Rezultatet e pritura:	Ndërtimi i kapaciteteve të punonjësve/eve të rinisë në mënyrë që të jenë reaktive ndaj nevojave të të rinjve/rejave dhe të përshtatin praktikatat dhe metodat e tyre në përputhje me punën cilësore të rinisë dhe parimet e edukimit joformal përmes manualeve dhe trajnerëve

ndërkombëtarë të YEU;

Ndërtimi i kompetencave të punonjësve/eve të rinisë në punën cilësore të rinisë dhe zbatimi i tij: ndryshimi në jetën e të rinjve dhe të rejave kërkon zhvillimin e burimeve njerëzore, zgjerimin e perspektivës së tyre, ndërtimin e kompetencave dhe oreksin për të mos ndaluar asnjëherë mësimin dhe eksplorimin;

Fuqizimi, motivimi dhe trajnimi i të targetuarve dhe organizatave të projektit, gjetja dhe shpërndarja e mjeteve (tools) të përbashkëta për të formuar planin e veprimit të përbashkët të organizatave të targetuara për mënyrën më të mirë të qasjes drejt të rinjve/rejave. Të shpërndajmë parimet dhe praktikatat e cilësisë së punës së të rinjve/rejave duke rritur ndërgjegjësimin për punën rinore dhe duke mbështetur zbatimin e tyre në nivel lokal e kombëtar dhe

Të hartojmë pikat e forta dhe të dobëta, ndikimin dhe kapacitetet e punës rinore dhe të arsimit joformal në organizatat anëtare/partnerë dhe të krijojmë një bazë të përbashkët për të kuptuar praktikatat dhe modelet tona të mira.